

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 51/26

Nr. i fq. / Br. st -4-

Data: / Datum 23.03.2026

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Komuna e Vushtrrisë  
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtri



### Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 51/26, 23.03.2026

### PROCESVERBAL

**nga mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 23 shkurt 2026 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:10.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Kushtrim Hyseni, Xhon Gubetini, Blerina Shala, Fatmire Cecelia, Ymer Haradinaj dhe Gentiana Rama (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Ferit Idrizi (Kryetar i Komunës) dhe drejtorët e drejtorive.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ajo tha se na ka ardhur edhe një pikë shtesë për ta shtuar në rend të ditës:

- Propozim-vendim për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë pikë që të shtohet në rend të ditës.***

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:***

### R E N D D I T E

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 27.01.2026;
2. Propozim – vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit të komunës nr. 01.189/23, datë 28.07.2023;
3. Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2025 në Komunën e Vushtrrisë;
4. Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2025;
5. Informatë lidhur me lejet ndërtimore, kushte ndërtimore dhe leje rrënimi për vitin 2025;
6. Raporti i sistemit të menaxhimit të performancës për vitin 2024;
7. Propozim-vendim për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 27.01.2026.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 27.01.2026.***

2. Propozim – vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit të komunës nr. 01.189/23, datë 28.07.2023.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – desha vetëm disa sqarime në mënyrë që të kontribuojmë, që ky propozim të na vjen në kuvend i plotësuar. Ushtruesi i detyrës së drejtorit ka bërë kërkesë që t'i vazhdohet për së paku 10 vite, kurse propozimin e kemi që prona të jepet në shfrytëzim për 40 vite. Pra, kemi një mospërputhje këtu. Nëse shohim vendimin e datës 28.07.2023, ka qenë dhënia në shfrytëzim për 3 vite me mundësi vazhdimi (afatshkurtër). Nëse vendosim t'ua japim për 40 vite, e kemi afatgjatë. Në parim jemi dakord për këtë çështje, por të koordinohemi mirë, në mënyrë që të mos bëjmë gabime ligjore.

**Lorik Maxhuni, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale** – tha se vendimi i kuvendit ka qenë për tri vite, por për shkak se investitori nuk ka arrit ta realizojë projektin për shkak se ka qenë në fazën inicuese për sigurimin e donacioneve, spitali “Sheikh Zayed” ka bërë kërkesë për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës. Është e vërtetë në e-mail që është cekur për 10 vite, por kemi diskutuar bashkërisht që t'ju jepet në shfrytëzim për 40 vite. Në momentin e ndërtimit të spitalit, automatikisht prona do t'i takojë spitalit dhe do të jetë në shfrytëzim të tyre. Ne me kryetarin jemi të hapur, nëse kuvendi e sheh të arsyeshme t'ju jepet për ndonjë periudhë tjetër.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – a është më mirë të ceket në vendim që dhënia në shfrytëzim është pa pagesë, sepse janë dy forma të dhënies në shfrytëzim: me pagesë dhe pa pagesë.

***Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

3. Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2025 në Komunën e Vushtrrisë.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – është një material i përgatitur mirë. Vetëm desha të bëjë disa pyetje: A janë funksionale të gjitha AMF-të? A shkon mjeku në secilën AMF, 5 ditë në javë? A është funksional laborator i analizave në Lumadh? Sa është numri i analizave që bëhen në laboratorin e QKMF-së? A është shtuar numri i tyre, krahasuar me vitet paraprake, apo kemi numër më të vogël?

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – kërkoi një raport apo informatë më të detajuar për Qendrën Rezidenciale në Lumadh, pasi që nuk është e përfshirë në raport.

**Lorik Maxhuni, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale** – theksoi se dy AMF nuk janë funksionale: në Stroc dhe Skromë. Jemi duke punuar me QKMF-në, në mënyrë që të largohen këto dy AMF, pasi janë jofunksionale. Tek laboratorin në Lumadh bëhet vetëm hemogrami, ku e kemi një problematikë, sepse sipas udhëzimit administrativ 04/2020 parashihet që në të gjitha QMF-të të ketë laborator aktiv, kurse ne kemi vetëm dy laboratorë. Jemi duke punuar që të rrisim numrin e analizave e po ashtu hapjen e një

laboratori të dytë të madh në Vushtrri, për shkak se kemi probleme me aparatura, si pasojë e ndjeshmërisë së madhe që kanë ato aparatura dhe kemi mbet edhe pa kontratë të servisimit.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

4. Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2025.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – theksoi se komandanti i stacionit policor na ka njoftuar se nuk mund të marrë pjesë as në KPF e as në kuvend, por që pyetjet mund t'i adresojmë me shkrim.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

5. Informatë lidhur me lejet ndërtimore, kushte ndërtimore dhe leje rrënimi për vitin 2025.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – kërkoi që të plotësohet dhe të përgatitet një informatë më e detajuar, duke specifikuar kategoritë e lejeve. Pra, të ceket se cilat objekte janë pa leje ndërtimore, e cilat janë në procedurë. Të sqarohet se cilat objekte janë të kategorisë I dhe II.

Ajo kërkoi që të sqarohet se për çfarë objektësh është fjala lidhur me këto kërkesa: 81 kërkesa për leje ndërtimore, 72 kërkesa për kushte ndërtimore, 9 kërkesa për leje rrënimi.

Ajo pyeti se objekti që po ndërtohet përballë komunës, a posedon leje ndërtimore? Ky objekt ua ka zënë dritaret banesave në të cilat jetojnë qytetarët.

Cecelia pyeti se objekti që është ndërtuar te “Ura e Silnicës”, në drejtim të fabrikës “Llamkos”, në anën e djathtë, a posedon leje ndërtimore?

Ajo po ashtu pyeti se objekti që është duke u ndërtuar në rrugën “Ismail Qemali”, te ish restoranti “Sueno”. Për këtë rast, është votuar në kuvend këmbimi i pronës, me qëllim të zgjerimit të rrugës. Pse nuk është bërë zgjerimi i rrugës? Çka ka ndodhë në këtë rast? Objekti veç ka dalë mbi tokë, pjesa tjetër tashmë është katër kate.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – deklaroi se në seancë të kuvendit të plotësohet kjo informatë dhe të vjen me narrativ, me shifra dhe detaje për secilën pyetje që parashtrou anëtarja e kuvendit. Sa i përket lejes ndërtimore për objektin afër komunës, ky është një rast shumë i vjetër dhe komuna disa herë ja ka refuzuar lejen. Ministria ka dhënë leje dhe mbi bazën e saj, komuna ka dhënë pëlqim. Operatori i ka shkelur vijat e ndërtimit dhe ju kanë vendos shiritat dhe sa kam informacion, ju ka tërheq leja ndërtimore. Kurse, lënda është në prokurori dhe nuk do të ndërtohet, por do të shkojë drejt procedurave të rrënimit. Për çështjet tjera, të gjitha do t'i keni të përgatitura për seancën e kuvendit.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Raporti i sistemit të menaxhimit të performancës për vitin 2024.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – nga ajo që po e shohim, ky raport është përgatitur nga MAPL-ja dhe asnjë fjalë nuk është shtuar nga komuna e Vushtrrisë. Në secilën tabelë,

të dhënat e paraqitura janë të komunave, ku në mesin e tyre është edhe komuna jonë. Koordinator i certifikuar për sistemin e menaxhimit të performancës, nuk kam parë që ka shkruar diçka specifikisht për komunën e Vushtrisë. Ai kërkoi që të bëhet një shtojcë dhe të bëhen krahasime me komunat tjera, në mënyrë që të dihet se në cilin vend është komuna jonë në përgjithësi, sepse aty janë disa fusha.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – deklaroi se ky është standard për të gjitha komunat, por i kemi informatat edhe për komunën tonë.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – theksoi se ministria i merr inputet nga komunat dhe në bazë tyre e harton raportin e performancës. Konsideroj se ky raport është standard dhe nuk mund të futet diçka shtesë.

**Islam Latifi, Koordinator i certifikuar për sistemin e menaxhimit të performancës** – tha se të gjitha komunat në bashkëpunim me MAPL-në kanë ndërtuar një sistem për menaxhim të performancës, i cili ka filluar të aplikohet diku nga viti 2009 dhe në vazhdimësi ka pasur rishikim të atij sistemi dhe treguesve, që ka pasur nganjëherë edhe zvogëlim të treguesve. MAPL-ja, përmes koordinatoreve lanson thirrjen për raportim në fillim të muajit shkurt, kurse faza e raportimit zgjat 45 ditë. Është një platformë (sistem) elektronike, ku koordinatori së bashku me 15 zyrtarë të komunës raportues (të caktuar me vendim të kryetarit të komunës) gjatë kësaj periudhe vendosin të dhënat në sistem. Pas grumbullimit të të dhënave, është faza e ankesave, nëse komunat nuk pajtohen me vlerësimin që bëhet nga MAPL-ja. Pas fazës së ankesave, hartohet raporti final dhe publikohet. Vitin e kaluar, raporti është publikuar diku kah muaji tetor dhe ka qenë e pamundur të diskutohet në kuvend atë kohë, për shkak se ka qenë vit zgjedhor. Prandaj, përveç që është obligim, është edhe tregues që e mat sistemi se a është diskutuar raporti i performancës në kuvend.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

7. Propozim-vendim për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Vushtrisë në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

Mbledhja përfundoi në orën **10:40**.

**Bujar Klinaku**



Procesmbajtës

**Melihate Basholli - Latifi**

  
Kryesuese e KK-së dhe KPF-së